



### HAPET THIRRJA E VIII E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS (PKPP)

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët shpalli më 1 qershor Thirrjen e VIII të PKPP-së me plot **1612 pozicione vakante** prej të cilave **704 në administratën shtetërore, 560 në njësitë e vetëqeverisjes vendore, 94 në institucionet e pavarura, 175 në shoqëritë tregtare dhe 79 në organizatat jofitimprurëse.** Thirrja e VIII e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës është një vazhdimësi e thirrjeve të mëparshme, që ka si synim zhvillimin e një praktike profesionale 3-mujore për **të gjithë të rinjtë 21-26 vjeç** dhe njihet si përvojë pune gjatë rekrutimit në institucionet e administratës shtetërore. Edhe përgjatë muajit qershor kanë vijuar sesionet informuese në kuadër të PKPP.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në sesionin informues të zhvilluar në Fakultetin e Ekonomisë në Tiranë dhe atë të zhvilluar në Techspace, për t'i informuar të rinjtë më shumë rreth Programit Kombëtar të Praktikave të Punës dhe i ftoi të gjithë ata që disponojnë diplomën e nivelit bachelor para datës 1 shtator, për të aplikuar duke bashkangjitur një CV dhe letër motivimi. **Përzgjedhja e të rinjve do të bëhet nga institucionet që marrin pjesë në PKPP dhe më pas të rinjtë do të zhvillojnë praktikën nga 1 shtator deri më 1 dhjetor.** Të rinjtë e vlerësuar me pikë maksimale, do të kenë mundësinë të punësohen me kontratë 1-vjeçare na bazë të performacës së tyre dhe nevojave të institucioneve pritëse.



### DITA E FËMIJËVE

Për 1 Qershorin, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka organizuar një **sërë aktivitetesh** me fokus te fëmijët **në Durrës, Vlorë, Kamëz dhe Tiranë.** Së bashku me Kryetaren e Bashkisë Durrës, Emiriana Sako dhe Ministrin e Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, Milva Ekonomi vizituan fëmijët në Shtëpinë e Foshnjës në Durrës, ku përveç se kanë kaluar momente të lumtura me fëmijët, u kanë dhuruar atyre disa lodra në këtë ditë të veçantë. Më pas, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka vizituar Shtëpinë e Fëmijës në Vlorë për t'u bërë pjesë e festës së 1 Qershorit të këtyre fëmijëve, të cilëve gjithashtu u ka dhuruar dhurata nga Hamleys. Aktivitetet për 1 Qershorin vijuan në Tiranë nën shoqërinë e Junior Minister, vajzës së përzgjedhur nga aplikimet e fëmijëve për të qënë pjesë e kabinetit për një ditë, Arsinës. Në Bashkinë Kamëz, ministrja mori pjesë në **inaugurimin e çerdhes "Pranvera" me kapacitet për 70 fëmijë dhe me kushte bashkëkohore.** Përpos inaugurimit të çerdhes "Pranvera", Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me kryetarin e Bashkisë Kamëz, Rakip Suli u bashkuan dhe në festimet e fëmijëve në kopshtin "Borëbardha" dhe "Zarife Hasanaj", ku fëmijët festuan me kërcime dhe lojra argëtuese pasi u vlerësuan dhe me "diplomat" e përfundimit me sukses të parashkollorit. Me rastin e vizitës së Presidentes të Republikës së Hungarisë, Sh. S. Znj. Katalin Novak, Junior Minister Arsina pati mundësinë të ndiqte në Parlament së bashku me ministren Muzhaqi, fjalën përshëndetëse të saj. Ky aktivitet u pasua nga një vizitë në shkollën "Servete Maçi", **ku edhe janë krijuar grupet e para të ekipeve sportive 8-10 vjeç.** Festimet për 1 Qershorin u mbyllën në aktivitetin "Festo me ne në gjuhën shqipe dhe të huaj", me fëmijët e Petrelës.



### PROGRAMI I KODIMIT DO TË OFROHET EDHE NË DIBËR

Programi i Kodimit filloi zbatimin më 23 janar 2023 dhe përgjatë këtyre muajve është ofruar në Tiranë dhe Korçë me mbështetje financiare nga qeveria shqiptare në masën 50% për studentët dhe të punësuarit, dhe në masën 100% për punëkërkuessit e papunë. Duke filluar nga ky muaj Programi i Kodimit do të ofrohet edhe në Dibër për të gjithë individët që duan të thellojnë njohuritë e tyre apo duan të ndryshojnë karrierën. Për grupin e parë që do të fillojë kursin më 1 korrik do të ketë financim 100%, nga ku 50% do të mbulohej nga qeveria shqiptare dhe 50% nga donatorë për t'ju krijuar kështu mundësinë edhe të rinjve në Dibër të zhvillojnë kurset fizikisht dhe të fitojnë njohuri të domosdoshme për t'u bërë pjesë e tregut shqiptar dhe atij ndërkombëtar online për të krijuar kështu standarde të larta për jetesën e tyre.

Aplikimet kanë filluar edhe për në Dibër në portalin e-Albania në shërbimin "Aplikim për kurset e zhvillimit profesional me mbështetje financiare". Aktualisht, pas 5 muajsh Programi i Kodimit numëron mbi 3400 aplikime dhe mbi 500 individë që po zhvillojnë kurset.



### SHPALLET FITUESI PËR PËRFAQËSUESIN RINOR NË BORDIN DREJTUES TË ZYRËS RAJONALE PËR BASHKËPUNIM RINOR

Më 10 maj, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë dhe Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), hapi thirrjen për përfaqësues rinor në Bordin Drejtues të RYCO. Thirrja u mbyll më 17 maj dhe pas një procesi votimi transparent nga organizatat rinore dhe për të rinjtë, Klajdi Priska u përzgjedh si përfaqësues i ri rinor në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, me plot 149 vota, për mandatin e ardhshëm me kohëzgjatje tre vjeçare, me anë të të cilit do të përfaqësojë interesat e rinisë shqiptare dhe do të jetë zëri i rinisë në mbledhjet e Bordit Drejtues të RYCO.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me Klajdin dhe Françeskën, ish-përfaqësuese rinore në Bordin Drejtues të RYCO diskutuan rreth detyrave që një përfaqësues rinor duhet të plotësojë, sfidat dhe të mirat e këtij pozicioni kaq të rëndësishëm. Françeska i dorëzoi mandatin e saj Klajdit bashkë me shumë këshilla të vjera për angazhimin ndaj rinisë dhe bashkëpunimit rajonal.





### NGRIHET KËSHILLI VENDOR RINOR I 59-TË NË TIRANË

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi së bashku me Nënkryetaren e Bashkisë, Ketil Luarasi dhe Drejtoreshën e Rinisë, Iva Beharaj morën pjesë në mbledhjen e zhvilluar në Bashkinë Tiranë për ngritjen e Këshillit Vendor Rinor të 59-të në Tiranë. Me pjesëmarrjen e shumë të rinjve pjesë e grupimeve të ndryshme nga çdo komunitet apo grup vulnerabël, në mënyrë që të gjithë të jenë të përfaqësuar dhe të dëgjuar, u përcaktuan detyrat e secilit prej anëtarëve të KVR Tiranë.

Në kuadër të plotësimit të qëllimeve dhe masave të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 për fuqizimin e zërit të të rinjve në procesin e vendimmarrjes lokale, janë ngritur strukturat e Këshillave Vendorë Rinorë në 59 bashki nga 61 në total, për t'ju ardhur në ndihmë të rinjve të çdo qyteti për të përcjellë kërkesat e tyre pranë bashkisë përkatëse, duke fuqizuar kështu zërin e tyre në proceset vendimmarrëse lokale. Këshilli Vendor Rinor shërben si mekanizëm ndërlidhës ndërmjet bashkisë dhe komunitetit rinor, për të evidentuar problematikat dhe sfidat që hasen nga të rinjtë në territorin ku jetojnë, njëkohësisht edhe për rritjen e përfshirjes së tyre në politikëbërje.



### PËRFUNDON ME SUKSES KAMPIONATI KOMBËTAR I EKIPEVE SPORTIVE

Pas një rrugëtimi të gjatë dhe të suksesshëm për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e përfshirë në Programin e Ekipeve Sportive, përgjatë muajit qershor është zhvilluar Kampionati Kombëtar i Ekipeve Sportive në shkolla për disiplinën e volejbollit dhe basketbollit, për vajza dhe djem të shkollave 9-vjeçare dhe gjimnazeve. Ekipet fituese u shpallën:

- 1.Ekipi i vajzave të qarkut Vlorë për shkollat 9-vjeçare në disiplinën volejboll
- 2.Ekipi i djemve të qarkut Tiranë për shkollat 9-vjeçare në disiplinën volejboll
- 3.Ekipi i vajzave të qarkut Shkodër për shkollat 9-vjeçare në disiplinën basketboll
- 4.Ekipi i djemve të qarkut Korçë për shkollat 9-vjeçare në disiplinën basketboll
- 5.Ekipi i vajzave të qarkut Fier për shkollat e mesme në disiplinën volejboll
- 6.Ekipi i djemve të qarkut Durrës për shkollat e mesme në disiplinën volejboll
- 7.Ekipi i vajzave të qarkut Tiranë për shkollat e mesme në disiplinën basketboll
- 8.Ekipi i djemve të qarkut Tiranë për shkollat e mesme në disiplinën basketboll

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me Komitetin Olimpik Shqiptar dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit kanë filluar me planifikimin për zgjerimin e programit Ekipet Sportive në Shkolla për vitin shkollor 2023-2024.







## MBAHET PANAIRI "ARTE DHE ZEJE 2023" NË KUADËR TË PROGRAMIT JASHTË ORARIT MËSIMOR

Më 2 qershor, nxënës të talentuar nga e gjithë Shqipëria u bashkuan në Panairin "Art dhe Zeje 2023", me performancat dhe punimet e tyre më të mira artizanale, pikturat e projektet inovatore në teknologji, që kanë përgatitur përgjatë viti shkollor së bashku me mësuesit e tyre në kuadër të programit "Jashtë Orarit Mësimor", i cili u zbatua gjatë këtij viti shkollor në 200 shkolla në të gjithë Shqipërinë, duke angazhuar mbi 600 mësues dhe mbi 10 mijë nxënës, dhe duke mbështetur këto shkolla me bazë materiale në ndihmë të veprimtarive krijuese. Në kuadër të programit Jashtë Orarit Mësimor nxënësit kanë ndjekur dy herë në javë kurse falas në pikturë, muzikë, kor, teatër, zeje, teknologji, sport dhe permakulturë. Programi ka për qëllim inkurajimin e mësimit të punimeve të artit dhe atyre artizanale përmes veprimtarive praktike, nxitjen e aftësive sipërmarrëse të nxënësve në perspektivën e ruajtjes dhe të promovimit të vlerave të komunitetit ku jetojnë, si dhe të trashëgimisë sonë kulturore në pikturë, vegla muzikore, zeje, teatër, sport, teknologji, etj.



## TIKKUN OLAM MAKERS (TOM)

TOM është një lëvizje globale që krijon dhe mundëson zgjidhje inovative dhe praktike për sfidat e përditshme të njerëzve me aftësi të kufizuara. Tikkun Olam Makers, që ka si qëllim të zgjidhë sfidat e njerëzve me aftësi të kufizuara në mënyrë inovative, sjell për herë të parë në Shqipëri risinë e krijimit dhe printimit të protezave me teknologji 3D me kosto të ulëta. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët me Romina Kostani, Drejtore Inovacioni dhe Promovimit të E-Gov pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Inovacionit dhe përfaqësues nga ekipi i AKSHI-t kanë zhvilluar një takim me të rinjtë në Fakultetin Ekonomik të Tiranës dhe një me të rinjtë në ambientet e Techspace, për të njohur të rinjtë me nismën e TOM në Shqipëri dhe njëkohësisht për t'i ftuar ata të bëhen pjesë e TOM për të dhënë kontributin për një kauzë kaq të drejtë dhe të rëndësishme. Së shpejti, ky shërbim i mrekullueshëm dhe me kosto të ulët do të ndryshojë jetën e shumë njerëzve në Shqipëri, ashtu siç ka ndryshuar edhe jetën e njerëzve në mbarë botën, veçanërisht fëmijëve.